



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:107523

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05360129

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.A. nga Ferizaj, me nr. personal ... dhe Sh.R. nga Ferizaj, me nr. personal ..., të cilët me autorizim i përfaqëson av. H.Rr. nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj, të cilën e përfaqëson avokati komunal S.V., me objekt kontesti kompensimi i shujtave dhe paga 13, vlera e kontestit 3632€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e publik, me datë 22.02.2024 ka marrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve A.A. nga Ferizaj dhe Sh.R. nga Ferizaj, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna Ferizaj që paditësit A.A. për periudhën 01.09.2017-30.08.2020 në emër të shujtës ditore për 608 ditët e pranisë në punë nga dy euro shumën prej 1216€, në emër të një page të 13-të shumën prej 605€, në total shumën prej 1821€ dhe paditësit Sh.R. për periudhën 01.09.2017-30.08.2020 në emër të shujtës ditore për 693 ditët e pranisë në punë nga dy euro shumën prej 1386€, në emër të një page të 13-të shumën prej 425€, në total shumën prej 1811€ si dhe shpenzimet procedurale në lartësinë prej 399€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre H.Rr. nga Ferizaj, më 03.09.2020, kanë ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shujtave dhe pagave jubilarë, vlera e kontestit mbi 1,000€. Në padi kanë theksuar se në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e paditura ka qenë e obliguar që paditësve t’ia kompensoj shujtën ditore dhe pagën jubilarë sipas përvojës së punës si dhe obligimet tjera të cilat burojnë nga kjo kontratë, të cilat asnjëherë nuk i ka përmbushur. Po ashtu në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Ferizaj me nr. 01.nr.2889, të datës 04.07.2003 e paditura ka pasur për obligim që të paguaj shujtën ditore në vlerë prej 2,00€ mirëpo këtë obligim nuk e ka përmbushur. Në shqyrtimin gjyqësor, i autorizuari i paditësve e ka precizuar kërkesëpadinë sipas parashtrësës së dt. 18.12.2023, me të cilën kërkon të detyrohet e paditura Komuna Ferizaj që paditësit A.A. për periudhën 01.09.2017-30.08.2020 në emër të shujtës ditore për 608 ditët e pranisë në punë nga dy euro shumën prej 1216€, në emër të një page të 13-të shumën prej 605€, në total shumën prej 1821€ dhe paditësit Sh.R. për periudhën 01.09.2017-30.08.2020 në emër të shujtës ditore për 693 ditët e pranisë në punë nga dy euro shumën prej 1386€, në emër të një page të 13-të shumën prej 425€, në total shumën prej 1811€ si dhe shpenzimet procedurale në lartësinë prej 399€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

E paditura në përgjigje në padi dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se pretendimet e paditësve janë të pa bazuara ngase në provat të cilat janë në shkresat e lëndës dhe nga pretendimet të bazës juridike nuk qëndrojnë dhe nuk ka baze juridike, këto e arsyetojmë me këto arsye se në kuptim të nenit 54, par.1 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës tekstualisht shkruan “te punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës prej 8 ore në ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për ditët e punës është 2 euro varesisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete”. Mirëpo në par.2 të të njëjtit nen shkruan aty ku nuk ka shtesa mbi pagën baze dhe ka mundësi financiare mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës, mirëpo në baze të provave materiale që janë në shkresat e lëndës e që janë listat e pagave të gjithë punetoret e komunes kanë marrë page shtese në lartësi prej 31 euro e 20 cent nga kjo rezulton fakti se punetoret përfitimin e kësaj të drejte e kanë realizuar në shtesën që është dhënë me pagat e rregullta kurse sa i përket pretendimeve për kompensimin e rrogës së 13 në kuptim të nenit 43, pika 6 e kësaj marrëveshje shkruan “Te punësuarit mund të njihet e drejta në bonuse dhe stimulime tjera në punë përfshirë edhe pagën e 13 në pajtim me mundësitë

materiale per pagesa te tilla”, paditesit me asnje prove materiale nuk kane mundur te vertetojne faktin se ka ekzistuar mundesia materiale per paditesit per pagen e 13 dhe qe ka pasur buxhet te mjaftueshem per vitet qe pretendojne sepse te drejtat qe burojne nga bonuset e stimulimeve dhe paga e 13 hyjne ne kategorine e kompensimeve per paga dhe meditje dhe organet komunale ashtu dhe organet shteterore asnjehere nuk kane parapare page te 13 dhe ne asnje vit nuk eshte vertetuar fakti se nga pagat dhe meditjet ka pas teprica apo shuma te parave te mbetura per vitin e ardhshem kalendarik, pagat dhe meditjet jane te rregulluara ne menyre strikte ne baze te planit vjetor te buxhetit dhe te ligjit financiar, kurse sa i perket bazueshmerise te nje vendimi te leshuar nga Kryetari i Komunes se Ferizaj me numer 2889 te dates 04.07.2003 ky vendim eshte vendim absolutisht i kunderligjshem dhe i pavlefshem njekohesisht ekziston edhe instituti i parashkrimit ne kuptim te nenit 373 te LMD-se te vitit 1978 dhe te nenit 354 te LMD te Republikes se Kosoves ku me keto dispozita jane parashkruar dhe vet e drejta subjektive ku buron nga e drejta objektive, ka kaluar afati 5 vjecar dhe afati 10 vjecar por njekohesht ne baze te dispozitave te tjera kemi parashkrim absolut. Nuk i ka kerkuar shpenzimet e procedurës.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Lista e pagave e muajit maj 2020 për paditësin e parë dhe e muajit qershor 2020 për paditësin e dytë, Vendim i Kryetarit të KK Ferizaj A.S., 01.nr.2889, i datës 04.07.2003, Akt emërimi dhe ndryshim plotësimi i aktit të emërimit për paditësin e parë i datës 01.07.2011 përkatësisht 01.05.2013, Akt emërimi i datës 01.07.2011 për paditësin e dytë, Vërtetim mbi përvojen e punës dhe i ditëve të punës i datës 14.12.2023 për paditësin e parë, Vërtetim mbi përvojen e punës dhe i ditëve të punës i datës 14.12.2023 për paditësin e dytë.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar.

Faktet

Me leximin e Listës së pagave e muajit maj 2020 për paditësin e parë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.A. kishte pagë neto 605.73€, pagë bruto 686.05€, si dhe përfitonte në emër të shtesave shumë prej 31.20€.

Me leximin e Listës së pagave e muajit qershor 2020 për paditësin e dytë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Sh.R. kishte pagë neto 425,43€, pagë bruto 474.12€ si dhe përfitonte në emër të shtesave shumë prej 31.20€.

Me leximin e Vendimit i Kryetarit të KK Ferizaj A.S., 01.nr.2..., i datës 04.07.2003, konstatohet se punëtorëve të administratës komunale në Ferizaj u kompensohet shujta e nxehtë në vlerë prej 2€ në ditë për ditët e punës.

Me leximin e Akt emërimit dhe ndryshim plotësimi i aktit të emërimit për paditësin e parë i datës 01.07.2011 përkatësisht 01.05.2013, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.A. ishte në marrëdhënie pune te e paditura si Inspektor i Njësisë së Tregut, kohëzgjatja pa afat, data e fillimit 01.07.2011, ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të dt. 01.05.2013 ndryshohet dhe plotësohet akt emërimi për A.A. si në vijim: nga vendi i punës Inspektor i Njësisë së Tregut avancohet në pozitën e Përfaqësuesit Juridik të Komunës në kuadër të Zyrës – Kabinetin e Kryetarit në harmoni me përgatitjen profesionale dhe me gradë më të lartë të pagës përkatësisht me koeficientin 9,00€.

Me leximin e Vërtetimit mbi përvojen e punës dhe i ditëve të punës i datës 14.12.2023 për paditësin e parë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.A. bazuar në listat e pagave të muajit korrik 2020 ka pasur 29 vite përvojë pune në administratën komunale dhe gjithsejt ditë pune viti 2017-55, 2018-258, 2019-212 dhe 2020-83,5.

Me leximin e Vërtetimit mbi përvojen e punës dhe i ditëve të punës i datës 14.12.2023 për paditësin e dytë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Sh.R. bazuar në listat e pagave të muajit nëntor 2023 ka 13 vite përvojë pune në administratën komunale dhe gjithsejt ditë pune viti 2017-64.5, 2018-267.5, 2019-221.5 dhe 2020-141.

Ligji i aplikueshëm

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e lidhur nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), saktësisht neni 4 thotë: “1.Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes. 2.Degët e sindikatave të veprimtarive joekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjet publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (ministritë përkatëse, atë të Administratës Publike, Arsimit, Shëndetësisë, etj), në pajtim me specifikat e tyre.”

Neni 43.6 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të lartë cituar përcakton se: “6.Të punësuarit, mund ti njihet e drejta në bonuse dhe stimulime tjera në punë, përfshirë edhe pagën e trembëdhjetë (13), në pajtim me mundësitë materiale për pagesat e tilla.”

Neni 54 i po kësaj marrëveshje poashtu parashikon se: “1.Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete. 2.Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës. 3. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim.”

Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme e Kosovës nr. 40/2023, i datës 27.02.2023, pika II. parasheh se: "Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014 dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015-31.12.2017.

Sipas nenit 3, paragrafi 1, pika 1.8 i këtij ligji parashihet se:”Kontrata kolektive është marrëveshje ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat i kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar në ligj dhe fakte. Gjykatës i rezultoi se pretendimi i paditësve që të detyrohet e paditura në përmbushjen e obligimeve nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lartë cituar sa i përket shujtave dhe pagës së 13-të është tërësisht i pabazuar dhe për këto arsye u desh të refuzohet.

Nga provat e administruara, por edhe nga pohimi i palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se paditësi A.A. kishte punuar te e paditura në cilësinë e përfaqësuesit juridik sipas ndryshimit dhe plotësimit të akt emërimit, i datës 01.05.2013. Sipas listës së pagave të paditësit të parë rezulton se paditësi A.A. kishte pranuar si shtesë në pagë shumën prej 31,2€. Kurse sipas listës së pagave të paditësit të dytë rezulton se paditësi Sh.R. kishte pranuar si shtesë në pagë shumën prej 31,2€. Kurse sipas dispozitës së nenit 54.2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës parashihet qartë se: “Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës”, që nënkupton se aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë (që nuk vlen për rastin konkret) dhe ka mundësi financiare mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës, ndërsa paditësit kanë pranuar shtesa mbi pagën bazë dhe ky nuk është fakt kontestues mes palëve dhe paditësit asnjëherë nuk e mohuan këtë fakt. Poashtu vlen të theksohet se dispozita e nenit 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës në të cilën thirret paditësi A.A. nuk zbatohet për avokatin e komunës, sepse Komuna është punëdhënës, ndërsa avokati paraqitet si përfaqësues i punëdhënësit që ka për obligim zbatimin e këtij neni, që nënkupton se obligimi nuk mund të shndërrohet në të drejtë, me arsyetimin se nuk mund punëdhënësi të përfitojë nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive sepse është debitor, është fakt se është përfaqësues por i debitorit, pra autorizimi i përfaqësuesit të komunës (avokatit komunal) në këtë rast paditësit A.A. buronte nga debitori që i bie nga Komuna Ferizaj, e cila tani në këtë çështje ka cilësinë e të paditurit. Të drejtat e përfaqësuesit të komunës të cilat rregullohen me akt emërim të veçantë nuk duhet ngatërruar me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, pasi kjo e fundit rregullon ato të drejta që për Komunën janë obligime, e që të cilat në cilësinë e punëdhënësit i ka marrë përsipër për t’i përmbushur, por që në rast kontesti për dhe në emër të tyre flet përfaqësuesi në këtë rast avokati komunal i saj. Sipas nenit 26.1 të Ligjit për përfaqësimin e institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore, ndërmjetësim dhe arbitrazh parashihet se: “1. Avokati i komunës përfaqëson dhe mbron komunën

në të gjitha çështjet ku komuna paraqitet si palë në procedurë.”. Dispozita e nenit 4.1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës flet qartë se kënd e obligon kjo marrëveshje, sipas të cilës dispozitë parashihet se: “1.Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes.” lidhur me nenin 2.1 të kësaj marrëveshje, në të cilën parashihet se: “1.Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje).” Kurse sipas nenit 1.2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës rregullohet se kush është palë në këtë marrëveshje, palë në këtë MPKK janë: përfaqësuesit e punëdhënësve, përfaqësuesit e të punësuarave dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Pretendimi i paditësve mbi ekzistimin e të drejtës në kompensimin e pagës së 13-të referuar në dispozitën e nenit 43.6 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive nuk qëndron sepse përpos se është kërkesë absolutisht e pabazuar dhe e pambështetur në prova dhe fakte relevante, është kërkesë e parashkruar (vjetëruar), konform nenit 87 të Ligjit të Punës i Kosovës, në të cilin përcaktohet se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.” sepse paditësit padinë e kanë paraqitur në gjykatë më dt. 03.09.2020 ndërsa kërkesën lidhur me pagën e 13-të e kërkojnë për vitin 2017. Poashtu për të përfituar të punësuarit këtë të drejtë e cila sipas dispozitës së lartë cituar të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës quhet “e drejta në bonuse dhe stimulime tjera në punë, përfshirë edhe pagën e 13”, duhet të reflektojnë dhe paraqesin dhe mbërrijnë të arritura jashtëzakonisht të larta dhe të suksesshme gjatë ushtrimit të detyrave të punës dhe përgjegjësive që rrjedhin nga marrëdhënia e punës gjë që paditësit nuk i kanë dorëzuar gjykatës prova dhe dëshmi lidhur me këtë çështje, pa e paragjykuar në asnjë formë suksesin e tyre në punë, sepse rëndom bonuset në gjitha shtetet jo vetëm në Kosovë, jipen në shenjë mirënjohje për sukseset e mëdha të arritura në punë nga ana e punëmarrësve si shpërblim nga ana e punëdhënësve. Gjykata vlerëson se neni 43.6 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka karakter detyrimor por vetëm paraqet një sugjerim për mundësitë materiale nëse ekzistojnë, ndërsa nuk është vërtetuar se ekzistojnë mundësitë materiale të paditurës.

Specifikisht Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme e Kosovës nr. 40/2023, i datës 27.02.2023, pika II. parasheh se: "Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014 dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarave (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura

të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015-31.12.2017.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale dhe ka shqyrtuar pretendimet e paditësve (gojore dhe atyre me shkrim), por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritorë të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK, në të cilin parashihet se: “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.” si dhe duke u bazuar në faktin se palët paditëse e humbën kontestin ndërsa i padituri nuk pati kërkesë për shpenzime.

Andaj, bazuar në nenin 7, 8, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 22.02.2024

Gjyqtari
Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.